



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -033

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-223 PËR
KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-223
PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS**

Neni 1

Pas nenit 3 të ligjit bazik, shtohet nen i ri 3/A me tekstin si vijon:

Neni 3/A
Statusi dhe stema

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në tekstin e mëtejme: Këshilli) gëzon subjektivitet juridik.
2. Këshilli dhe gjykatat kanë stemën sipas ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, e cila përdoret në të gjitha dokumentet, vendimet dhe aktgjykimet.

Neni 2

1. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13 pas fjalës “degë”, fshihet lidhëza “dhe” dhe shtohet fjala “punësimin dhe”.
2. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafët 1.19 dhe 1.25 fshihen nga teksti i ligjit.

3. Neni 4 i ligjit bazik , paragrafi 1, pas nënparagrafit 1.27 shtohen nënparagrafët e ri 1.28, 1.29, 1.30, 1.31, 1.32, 1.33, 1.34, me tekstin si në vijim:

1.28. nxjerrjen e rregullores për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për organizimin e provimit për kandidatë për gjyqtarë;

1.29. shpalljen dhe organizimin e provimit për gjyqtarë;

1.30. nxjerrjen e rregullores për procedurën e përzgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe të kryetarëve të gjykatave;

1.31. themelimin e degëve të gjykatave në pajtim me Ligjin për Gjykatat;

1.32. bashkëpunon me këshillat gjyqësor të shteteve të tjera dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare;

1.33. menaxhimin e sistemit qendror të evidencës penale. Procedura dhe rregullat e tjera në lidhje me evidencë penale do të vendosen me rregullore të miratuar nga Këshilli.

1.34. kryen edhe punë tjera të caktuara me ligj.

Neni 3

1. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 1, pas fjalës “Kushtetutë” shtohen fjalët “me mandat pesë (5) vjeçar”.

2. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 2, pas fjalës “sipas” fshihen fjalët “nenit 65 (10) dhe”.

3. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 3, fshihet nga teksti i ligjit.

4. Neni 5 i ligjit bazik, pas paragrafit 4, shtohen paragrafët 5, 6, 7, 8, 9 me tekstin si në vijim:

5. Anëtarët e Këshillit pasqyrojnë natyrën shumetnike dhe parimet e barazisë gjinore në Republikën e Kosovës. Këshilli do të miratoj rregullore të veçantë për zbatimin e këtij paragrafi.

6. Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të anëtarit të Këshillit, i njëjti nuk mund të ngritët në detyrë, si dhe nuk mund të emërohet Kryetar i Gjykatës përkatëse.

7. Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë në kompensim për punën e tyre si anëtar të Këshillit. Këshilli do të miratojë skemën e kompensimit përkatësisht pagën.

8. Kryetarët e Gjykatave dhe kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

9. Anëtari i Këshillit që vjen nga Oda e Avokatëve nuk mund të ushtojë detyrën e avokatit derisa është anëtar i Këshillit. Paga e anëtarit nga Oda e Avokatëve, caktohet dhe paguhet nga Oda e Avokatëve.

Neni 4

Pas nenit 5 të ligjit bazik shtohet neni i ri 5/A me tekstin si në vijim:

Neni 5/A

Procedura e propozimit, zgjedhjes dhe e shkarkimit të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor që zgjidhën nga Kuvendi

1. Procedura për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga Kuvendi, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 2, 3 dhe 4 i Kushtetutës, fillon gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit të anëtarit.
2. Përgjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kur mandati përfundon para kohe, siç përcaktohet me këtë ligj, procedura për zgjedhjen e anëtarit fillon brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e mbetjes së vendit të lirë.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës e shpall konkursin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit në media të shkruara dhe elektronike.
4. Komisioni përkatës i Kuvendit përcakton kriteret e konkursit për zgjedhjen e anëtarit. Afati i kohëzgjatjes së konkursit nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15), e as më i gjatë se njëzet (20) ditë.
5. Pas skadimit të afatit të paraparë në paragrafin 4 të këtij neni, Komisioni përkatës i Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, vlerëson nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur anëtarë të këshillit, dhe hedh poshtë kandidaturat që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në konkurs.
6. Komisioni zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili plotëson kushtet për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit dhe në bazë të të dhënave të paraqitura dhe rezultateve të intervistës, përgatitë listën e ngushtë të kandidatëve.
7. Lista për mbledhjen e Kuvendit përmban dy (2) kandidatë për një pozitë.
8. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votim të fshehtë zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor.
9. Nëse në rrethin parë kandidatët e propozuar nga Komisioni përkatës i Kuvendit nuk marrin shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, atëherë në raundin e dytë konsiderohet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave.
10. Anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi shkarkohen nga detyra në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me propozim të Këshillit.

Neni 5

Neni 6 i ligjit bazik, paragrafi 3, pas fjalës “propozon”, fshihen fjalët “Ministrisë së Financave dhe”.

Neni 6

Neni 8 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 8 **Përfundimi i mandatit**

1. Mandati i anëtarit të Këshillit përfundon me:

1.1. vdekje;

1.2. humbjen e zotësisë për veprim për më shumë se tre (3) muaj për shkaqe mjekësore të vërtetuara;

1.3. dështimin e vazhduar për të marrë pjesë në veprimtaritë e Këshillit për më gjatë se tre (3) muaj;

1.4. pushimin e statusit mbi të cilin bazohet emërimi;

1.5. skadimin e mandatit;

1.6. dorëheqje, duke i ofruar Këshillit njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh.

2. Anëtarët e Këshillit shkarkohen nga funksioni para skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur, nëse:

2.1. funksionin e anëtarit të Këshillit nuk e kryen në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin;

2.2. ushtron funksionin në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij, dhe

2.3. është dënuar për vepër penale.

3. Nëse një vend në Këshill lirohet para skadimit të mandatit të një anëtari, pozita e lirë plotësohet në të njëjtën mënyrë si për anëtarin të cilit i ka skaduar mandati. Personi, i cili zgjedhet të plotësojë një vend të lirë në Këshill emërohet apo zgjedhet me një mandat të plotë pesë (5) vjeçar.

Neni 7

Neni 9 i ligjit bazik, pas nënparagrafit 1.4, shtohet nënparagraf i ri 1.5. me tekstin si në vijim:

1.5. Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve.

Neni 8

Neni 12 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 12 Përgjegjësia personale e anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit nuk mbajnë përgjegjësi penale për vendimet, mendimet dhe veprimet, brenda fushëveprimit të tyre si anëtar të Këshillit”.

Neni 9

Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 1 riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Këshilli përgatit propozimin e buxhetit vjetor dhe ia dërgon propozimin e tillë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 10

1. Neni 19 i ligjit bazik, paragrafi 4, pas fjalëve “me shkrim”, shtohet fjala “në Këshill”.

2. Neni 19 i ligjit bazik, pas paragrafit 4, shtohen paragrafët e ri 5 dhe 6 me tekstin si në vijim:

5. Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve me mandat fillestar bëhet së paku dy herë gjatë këtij mandati nga Komisioni për vlerësim të performancës së gjyqtarëve, një herë pas trajnimit fillestar dhe një herë në fund të mandatit fillestar. Kriteret për vlerësim gjatë mandatit fillestar do të specifikohen në një rregullore të nxjerrë nga Këshilli.

6. Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve me mandat të përhershëm bëhet çdo tre (3) vjet, në mënyrën e tillë që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji Këshilli cakton me short 1/3 e gjyqtarëve, brenda secilës gjykatë, si grupin e parë të cilët do t’u nënshtrohen vlerësimit të performancës në afat prej tre (3) muajsh. I njëjti short mbahet pas një (1) viti për t’ i caktuar gjyqtarët që do bëjnë pjesë në grupin e dytë, dhe grupin e tretë pas dy (2) viteve respektivisht.

Neni 11

Pas nenit 19 të ligjit bazik, shtohet neni ri 19/A me tekstin si në vijim:

Neni 19/A

Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve

1. Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve përbëhet nga gjyqtarë me përvojë në sistemin gjyqësor të Kosovës.
2. Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve udhëhiqet nga një anëtar i Këshillit nga radhët e gjyqtarëve.
3. Vlerësimi i Komisionit është bazë për avancimin apo uljen në detyrë si dhe për shkarkimin nga detyra e gjyqtarit. Vlerësimi i tillë duhet të bazohet në kritere objektive, të matshme dhe tërësisht transparente. Objektiviteti i një vlerësimi të tillë duhet të reflektojë metoda të çmuara të nivelit të praktikave ndërkombëtare, dhe të cilat janë skajshmërisht të arsyetuara dhe transparente.
4. Komisioni për punën e tij i përgjigjet Këshillit.
5. Përbërja, mandati, kriteret, mënyra dhe çështje tjera lidhur me vlerësimin e performancës së gjyqtarëve rregullohet me këtë ligj dhe rregullore të miratuar në Këshill.

Neni 12

Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 7 fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 13

Neni 28 i ligjit bazik, paragrafi 3, pas fjalës: “Sekretariatit”, fshihet fjalia “Drejtori nuk pranon kompensim shtesë për detyra apo punësim tjetër nga cilido burim tjetër përveç rimbursimit për shpenzime të arsyeshme dhe të nevojshme”.

Neni 14

Neni 30 i ligjit bazik, paragrafi 3, pas fjalës: “Gjyqësorit”, fshihet fjalia “Drejtori nuk do të pranojë kompensim shtesë për çfarëdo detyre apo punësimi nga cilido burim tjetër përpos rimbursimit për shpenzime të arsyeshme dhe të nevojshme”.

Neni 15

Neni 36 i ligjit bazik, pas paragrafit 4, shtohen paragrafët i ri 5 dhe 6, me tekstin si në vijim:

5. Procedura nuk do të fillohet dhe zbatohet në Komision pasi të kaloj afati një (1) vjeçar nga njoftimi i pranuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, për shkeljen e supozuar dhe dy (2) vite nga dita e shkeljes së supozuar.

6. Në rastin kur Zyra e Prokurorit Disiplinor ka lejuar parashkrimin e lëndës, ose shtyrjen e dërgimit të saj në gjykim të Komisioni Disiplinor, gjë e cila rezulton ta pamundësojë këtë të fundit për ta shqyrtuar atë sipas këtij ligji, Komisioni detyrohet ta njoftojë Këshillin për një lëshim të tillë të zyrës së Prokurorit Disiplinor. Mbi një lëshim të tillë këshilli kërkon përgjegjësi zyrtare nga zyra e prokurorit disiplinor dhe nëse për një gjë të tillë nuk merret përgjigje e arsyetuar, një lëndë të tillë detyrueshëm ja adreson Prokurorit të Shtetit për hetim eventual të keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga Zyra e Prokurorit Disiplinor.

Neni 16

1. Neni 39 i ligjit bazik, pas paragrafit 4, shtohen paragrafët i ri 5 dhe 6 me tekstin si në vijim:

5. Këshilli gjatë vendosjes për ankesë mund të refuzojë ankesën, të vërtetojë ose të ndryshojë vendimin ose ta prishë dhe ta kthej në rishqyrtim Komisionit Disiplinor.

6. Vendimi i tillë i Këshillit duhet të jetë i arsyetuar sa i takon provave të administruara nga të dyja palët, interpretimit të shkeljeve të pretenduara, dhe masës së dënimit të argumentuar që do t'i përshtatej arritjes së qëllimit të përcaktuar me këtë ligj. Në një rast të tillë, vendimi i Këshillit duhet të reflektojë, dhe të arsyetojë, zbatimin e parimit të proporcionalitetit në vendosjen për çështjen e tillë. Një vendim i tillë bëhet transparent sipas kushtëzimeve të ligjit mbi të dhënat personale të Republikës së Kosovës.

Neni 17

Rregulloret e përcaktuara në këtë ligj do të nxirren në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 18 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës

**Ligji Nr. 05/L -033
28 maj 2015**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI